



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6984 Prot.

Roskovec, më 29.09 2020

VENDIM

NR 72 .DATË 28.09 .2020

**“PËR NDRYSHIM DHE DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.105 DATË 22.11.2019“PËR
MIRATIMIN E PAKETËS FISKALE PËR VITIN 2020”**

Në mbështetje të:

- Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Neni 29 pika 2, Neni 54 gërma f.
- Ligjit Nr. 152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin"
- VKM-së Nr. 607, datë 29.07. 2020 “Tarifat për llojet e shërbimeve që ofrohen nga Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi”,Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Miratimin e ndryshime dhe disa shtesa në paketën fiskale të Bashkisë Roskovec të miratuar me VKB Nr.105,datë 22.11.2019 "*Për miratimin e paketës fiskale 2020*" si më poshtë:
 - a) Ndryshim konkretisht në kreun II, pika 11 "Tarifat e urbanistikës".

Emërtimi i tarifës	Vlera e tarifës (Ishte)
Tarifë për Akt – Teknik per sa i perket masave te mbrojtjes nga zjarri	1000 lekë
Tarifë për Akt – Teknik per sa i perket masave te mbrojtjes nga zjarri	Bëhet Shfuqizohet

- b) Në kreun II, bëhet shtesë pika 12 "Tarifat për llojet e shërbimeve në favor të shtetasve, subjekteve, fizike dhe juridike, që ofrohen nga Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin"si me poshtë:

12.1 Shërbimi për vlerësimin dhe miratimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri për objekte të destinuara për banim.

- a) Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte me lartësi :

Lartësia	Tarifa
deri në 12 metër	5 000 (pesë mijë) lekë
nga 12 deri në 24 metër,	15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë
nga 24 deri në 32 metër	20 000 (njëzetë mijë) lekë
nga 32 deri në 54 metër	30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

12.2 Shërbimi për vlerësimin dhe miratimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik (sektori i bujqësisë, sektori i industrisë, sektori i transportit, sektori i tregtisë, sektori i turizmit, sektori i shërbimeve, etj.)

- b) Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik pavarësisht sektorit, për objekte me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi:

Sipërfaqja	Tarifa
Deri në 500 m ²	5 000 (pesë mijë) lekë
Nga 501 deri në 1 000 m ²	10 000 (dhjetë mijë) lekë
Nga 1001 deri në 2000 m ²	20 000 (njëzetë mijë) lekë
Nga 2001 deri në 3000 m ²	30 000 (tridhjetë mijë) lekë
Mbi 3000 m ²	50000 (pesëdhjetë mijë) lekë

12.3 Shërbimi për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objektet/aktivitetet me rrezikshmëri të lartë zjarri.

Emërtimi	Tarifa
Për stabilimente për përpunimin e drurit me materiale në përpunim dhe/ose në ruajtje	10.000 (dhjetë mijë) lekë
Për fabrika dhe impiante ku prodhohen, përpunohen dhe/ose mbahen produktet e tekstilit, natyrore/artificiale, produktet e linoleum-it dhe produkte të tjera të ngjashme	10.000 (dhjetë mijë) lekë

Për stabilimentet dhe impiantet për prodhimin, përpunimin dhe rigjenerimin e laboratorëve të gomës, depozitat e gomës, pneumatikëve dhe produkteve të ngjashme	10.000 (dhjetë mijë) lekë
Për depot ku prodhohen, përpunohen dhe/ose mbajnë plastikë	10.000 (dhjetë mijë) lekë
Për stabilimentet dhe impiantet për prodhimin, letër dhe karton, dhe përgatitja e produkteve të letrës në përgjithësi	10.000 (dhjetë mijë) lekë

12.4 Shërbimi për vlerësimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për objektet/aktivitetet ku janë të instaluara pajisje nën presion:

Emërtimi	Tarifa
Për rezervuarë gazi të lëngshëm, në sasi totale masive më të mëdha se ose të barabartë me 75 kg deri në 300 kg,	10.000 (dhjetë mijë) lekë
Për rezervuarë gazi të lëngshëm, në sasi totale masive më të mëdha se ose të barabartë me 300 kg deri në 1000 kg	15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë
Për rezervuarë gazi të lëngshëm në sasi totale masive më të mëdha se ose të barabartë me 1000 kg	20.000 (njëzet mijë) lekë
Për stabilimente/impianete ku lëngjet e ndezshme dhe/ose të djegshme me pikë ndezjeje prodhohen dhe/ose përdoren deri në 125°C, me sasi totale në cikël dhe/ose në ruajtje, më e madhe se 1 m ³	10.000 (dhjetë mijë) lekë
Për stabilimente/impianetet për përgatitjen e vajrave vajosëse, vajrave diatermike dhe të ngjashme, me pikë flakërimi më të lartë se 125°C, me sasi më të larta të përgjithshme në cikël dhe/ose në ruajtje deri në 5 m ³	10.000 (dhjetë mijë) lekë
Për stabilimente/impianete për përgatitjen e vajrave vajosëse, vajrave diatermike dhe të ngjashme, me pikë flakërimi më të lartë se 125°C, me sasi më të larta të përgjithshme në cikël dhe/ose në ruajtje deri 100 m ³	20.000 (njëzet mijë) lekë
Për stabilimente/impianete për përgatitjen e vajrave vajosëse, vajra diatermike dhe të ngjashme, me pikë flakërimi më të lartë se 125°C, me sasi më të larta të përgjithshme në cikël dhe/ose në ruajtje mbi 100 m ³	20.000 (njëzet mijë) lekë
Për sisteme të shpërndarjes së karburantit të lëngshëm, kontejnerët e palëvizshëm të karburanteve të lëngshëm deri në 9 m ³ , me pikë të ndezjes mbi 65°C	10.000 (dhjetë mijë) lekë.
për sisteme fikse për shpërndarjen e karburanteve të gaztë dhe tipit të përzier (të lëngshëm dhe të gaztë),	20.000 (njëzet mijë) lekë
për sisteme të shpërndarjes së gazit të karburantit për automjete motorike dhe sisteme të shpërndarjes së palëvizshme për benzinë, naftë dhe miks automobilistik, për përdorim publik dhe privat	20.000 (njëzet mijë) lekë

12.5 Shërbimi për vlerësimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për objektet/aktivitetet e mëposhtme:

Për hidrocentrale, HEC (primar, sekondar) etj., impianteve të prodhimit të energjisë elektrike, të rinovueshme, diellore, ere, etj	20 000 (njëzet mijë) lekë
Për vend depozitime të mbetjeve të ngurta	10 000 (dhjetë mijë) lekë
Për rrugë, hekurudha, ura, tunele	20 000 (njëzet mijë) lekë
Për vlerësimin dhe miratimin e ndryshimeve të projektit të MZSH-së, të miratuar më parë nga struktura e MZSH-së, për shkak të instalimit të sistemeve të reja, zgjerimit apo ristrukturimit të aktiviteteve ekzistuese	5 000 (pesë mijë) lekë
Për dhënien e certifikatës së sigurisë nga zjarri, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objektet që ushtrojnë aktivitete, sipas klasifikimit të rrezikshmërisë nga zjarri	5 000 (pesë mijë) lekë.
Për ripërtëritjen periodike të certifikatës së sigurisë nga zjarri, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin	2 000 (dy mijë) lekë
Për lëshimin e vërtetimit të zjarrit (shoqëruar nga raporti i ndërhyrjes), nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin	1 000 (një mijë) lekë
Për lëshimin e vërtetimit (shoqëruar nga akti i kontrollit i kryer nga inspektori i shërbimit të MZSH-së), për depozitat e gazeve të ndezshme, të ngurta, apo plazma në automjete të lëvizshme rrugore, nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin	1 000 (një mijë) lekë
Për inspektimin e objekteve për masat e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, kur inspektimi nuk është i autorizuar nga shërbimi i MZSH-së, por kërkohet nga vetë subjektet fizikë dhe juridikë	5 000 (pesë mijë) lekë për një orë
Për vënien në dispozicion të personelit dhe të një automjeti në zhvillimin e aktiviteteve sportive, kulturore, si panaire, ekspozita, koncerte, shfaqje, festivale të ndryshme, në mjedise të hapura dhe të mbyllura publike, si dhe gjatë zhvillimit të aktiviteteve sportive kombëtare apo ndërkombëtare	10 000 (dhjetë mijë) lekë për një orë
Për ofrimin e shërbimeve subjekteve private me automjete zjarrfikëse, me pajisje zjarrfikëse, apo me autoskallë	10 000 (dhjetë mijë) lekë për një orë
Për ofrimin e shërbimit me motopompë (largim të ujërave për shkak të reshjeve), subjekteve private	5 000 (pesë mijë) lekë për një orë
Për trajnimin e personave, të subjekteve fizikë dhe juridikë për mbrojtjen nga zjarri nga strukturat e shërbimit të MZSH-së në Akademinë e Sigurisë (Qendra e Trajnimit Zjarrfikës)	2 000 (dy mijë) lekë në ditë për person
Për kryerjen e aktit të ekspertimit apo riekspertimit, nga strukturat e MZSH-së së bashkisë, në rastet e zjarreve të rëna në objekt, kur	20 000 (njëzetë mijë) lekë

kërkohet nga subjekte fizikë e juridikë	
Për të gjitha ndërhyrjet kur kërkohet nga subjekte fizikë e juridikë (zhbllokime dyersh, ashensorë, apo shërbime të tjera të ngjashme), që do të kryhen nga shërbimi zjarrfikës i bashkisë	2 000 (dy mijë) lekë

12.6. *Tarifat e përcaktuara në këtë vendim nuk aplikohen në raste të emergjencave civile dhe ngjarjeve të ndryshme aksidentale.*

3.1 Ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit për zbatimin dhe ekzekutimin e këtij vendimi.

- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

